



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 67, DATË 21.08.2020

PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT, SHOQËRISË “TV GOLD” SH.P.K., PËR OFRIMIN E
SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV ONLINE, MBËSHTETUR NË
INTERNET “TV GOLD”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/c të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1026 prot., datë 03.04.2020, të shoqërisë “Tv Gold” sh.p.k., për pajisje me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në internet “Tv Gold”, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit, shoqërisë “TV Gold” sh.p.k. me administrator: Z. Artan Xhaferri, me NIPT: M01324502F, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në internet “Tv Gold”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|------------------|---------|------------|
| Kryetar: | Gentian | SALA |
| Zëvendëskryetar: | Sami | NEZAJ |
| Anëtarë: | Agron | GJEKMARKAJ |
| | Gledis | GJIPALI |
| | Suela | MUSTA |